



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:013662
Datë: 04.06.2018
Numri i dokumentit: 00053388

P.nr.155/17

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Gani Kastrati, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Shureta Ballxhi procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit: A. B. nga Prizreni, për shkak të veprës penale „vjedhje nga neni 325,parag.2 lidhur me oarag.1 të,KP-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.1701-1/16, të datës 19.01.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në praninë e Prokurorit të Shtetit në Prizren – departamenti i përgjithshëm Shpend Binaj dhe të akuzuarit, me datë 10.05.2018, publikisht mori dhe në prezencën e palëve shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A. B., nga i ati R., nga e ëma S.,e lindur R., i lindur me datën *data e lindjes...*, në Prizren,ju edhe tani jeton në rrugën ...nr... , i pamartuar, ka kryer gjashtë klasë të shkollës fillore,i pa punë,i gjendjes së dobët ekonomike,me numer personal: *numri personal...* , shqiptar,shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

Me datën 08.07.2016 rreth orës 03:50 minuta,në Prizren, në lagjen ...,saktësisht në marketin “T. J.”,pronë e të dëmtuarit J. D.,në bashkveprim me të miturin E. Sh.,ia marrin pasurinë e luajtshme të tjetrit me qëllim të përvetsimit të kundërligjshëm për vete,në atë mënyrë që i pandehuri A. B. në sjoqëri me të miturin E. Sh.,duke e përdorë forcën,e thejnë frigoriferin e vendosur jashtë marketit,dhe nga atz marrin akullore dhe çokollata,në vlerë prej 30 Euro,me të cilat veprime të dëmtuarit i kanë shkaktuar dëm material.

Këso dore ka kryer veprën penale „vjedhje nga neni 325 parag.2,lidhur me parag.1 të KP-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 8, 9, 10, 21, 27, 41, 42, 46, 49, 50, 51, 52, 73, nenit 321 paragraf 1 të KP-së dhe nenit 365 të KPP-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIMIN ME KUSHT

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **3 (tre) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej **1 (një) viti** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në qoftë se e akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Pala e dëmtuar J. D. nga Prizreni rr. ... pa.nr për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro, si dhe në emër të kompensimit për viktimat e krimit shumën prej 30 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.1701-1/16 të datës 19.01.2017, kundër të akuzuarit A. B. nga Prizreni, për shkak të veprës penale ,vjedhje nga neni 325 paragraf 2, lidhur me paragraf 1 të KP-së. Në seancën fillestare në prezencën e paleve pasi që u lexua aktakuza nga anan e Prokurorit të shtetit, Gjykata shpali dhe bëri prezentimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarit. I akuzuari deklaroi se nuk i kundërshtoi provat me të cilat mbështet aktakuza, andaj dhe në mënyrë vullnetare ka pranuar fajsin për veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Me datën 08.07.2016 rreth orës 03:50 minuta, në Prizren, në lagjen... ,saktësisht në marketin "T. J.", pronë e të dëmtuarit J. D., në bashkveprim me të miturin E. Sh., ia marrin pasurinë e luajtshme të tjetrit me qëllim të përvetsimit të kundërligjshëm për vetë, në atë mënyrë që i pandehuri A. B. në sjoqëri me të miturin E. Sh., duke e përdorë forcën, e thejnë frigoriferin e vendosur jashtë marketit, dhe nga atë marrin akullore dhe çokollata, në vlerë prej 30 Euro, me të cilat veprime të dëmtuarit i kanë shkaktuar dëm material.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajsisë nga ana e të akuzuarit i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht është paraqitur në gjykatë dhe ka pranuar fajin, për shkak të cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata, konform nenit 257 të KPP, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhë në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhje nga neni

325 parag.2, lidhur me parag.1 të KP-së , dhe për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin me kusht, paraprkisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, nuk ka gjetur rrethana rënduese, e si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, vullnetarishtë dhe pa presion, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, ,shprehet i penduar për veprën që është i akuzuar , ,i papunë dhe dhe lut gjykatën të shqiptoj një dënim sa më të butë, premton që nuk do përsëris veprime të tilla në të ardhën, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti, i akuzuari nuk kryen vepër të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së saj dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshem dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarin në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marë konform nenit 463 par.1 e 2 të KPP.

Vendimi mbi shpenzimet dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim te nenit 453 par. 1 të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i përgjithshëm
P.nr.155/17, të datës 10.05.2018

Sekretare Juridike
Shureta Ballxhi

Gjyqtari
Gani Kastrati

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.